



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për Media

8 shkurt 2021

RrGK përkrah protestën e sotme në Prizren: Drejtësi për secilën grua të vvarë!

Vrasja dhe dhuna ndaj grave po vazhdojnë të mos marrin dënimin e merituar nga institucionet tona të drejtësisë. Madje, kjo edhe pse janë bërë të gjitha ndryshimet në kornizën ligjore, e së fundi, gjatë vitit 2020 edhe futja e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, e cila kërkon dënime meritorë për ushtruesit e dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Kosova ende po dështon të ndëshkojë vrasësit e grave. Së fundi, më 3 shkurt 2021, Gjykata Themelore e Prizrenit e dënoi me 15 vjet burgim Ilir Haxhiajn, i cili në vitin 2019 e rrahu dhe e vrau bashkëshorten e tij, Hatije Dinën. Ai u dënua për veprën "lëndim i rëndë trupor".

Për ta kundërshtuar këtë vendim, dhe për t'i 'rikujtuar' Gjykatës Themelore të Prizrenit se ky "lëndim trupor" i mori jetën Hatije Dinës, nën organizimin e [Kolektivit për Mendim dhe Veprim Feminist](#), dhjetra aktivistë protestuan sot me fillim nga ora 12:00, para Gjykatës Themelore të Prizrenit.

Duke përkrahur këtë protestë, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) vlerëson se klasifikimi dhe dënimi i Ilir Haxhiajt me veprën "Lëndim i Rëndë Trupor" është krejtësisht i padrejtë dhe në kundërshtim me kornizën ligjore në vend.

Presim që zëri i këtyre aktivistëve që protestuan sot, të arrijë te Gjykata e Apelit, në mënyrë që ata ta shpallin të pavlefshëm këtë dënim të dhënë nga Gjykata Themelore në Prizren.

Gjithashtu, RrGK përmes kësaj kumtese njofton se do të monitorojë për së afërmi ecurinë e këtij procesi gjyqësor.

Drejtësi për gratë e vrara! Drejtësi për secilën grua të vvarë!